



REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK
Nr. i fq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.	03-02/3480/16
Data Datum Date	04-10-2016
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 03.10.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-2784/16, për zyrtarin e lartë, z. Feti Krasniqi, Drejtor i Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Lipjanit, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-02-2784/16, qe për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Feti Krasniqi, Drejtor i Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Lipjanit.

Gjatë zhvillimit të procedurës për identifikimin e rasteve të konfliktit të interesit apo mos pajtueshmërisë në ushtrim të funksionit publik është vërejtur se zyrtari i lartë, z. Feti Krasniqi, Drejtor i Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Lipjanit, figuron si person i autorizuar në një biznes privatë e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L- 051, kjo situatë paraqet konflikt të mundshëm interesit dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejtë në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet qe posedon Agjencia.

Pas kësaj shkrese z. Feti Krasniqi, ka kontaktuar me zyrtaret e AKK-së dhe ka shprehur vullnetin që të takohet me personat kompetent për tu informuar lidhur me rastin e iniciuar për situatë të mundshëm të Konfliktit të Interesit.

Gjatë takimit të organizuar në zyrat e AKK-së me zyrtarin e lartë z. Feti Krasniqi, janë prezantuar provat të cilat lidhen me rastin e z. Krasniqi. Ne këtë takim z. Krasniqi është pajtuar me faktet e prezantuara dhe na ka njoftuar se ne biznesin ku ai figuron si person i autorizuar nuk ushtron aktivitetet dhe nuk ka asnjë funksion ne këtë biznes, por vetëm ka mbet i regjistruar si person i autorizuar nga koha kur nuk ka ushtruar funksionin e zyrtarit të lartë.

Zyrtari i lartë z. Krasniqi është zotuar se brenda afatit ligjore do të kërkoj nga pronari i këtij biznesi që ta heq emrin e tij nga regjistri ku figuron si person i autorizuar dhe do të sjell dëshmitë të lëshuara nga organi kompetent në këtë rast ARBK-ë.

Gjatë këtij takimi zyrtari i lartë z. Feti Krasniqi, na ka njoftuar edhe për angazhimin e tij në një organizatë Jo Qeveritare e cila merret me fushën e edukimit, aftësimin profesional zhvillimit socio-ekonomik dhe të drejtave të njeriut.

Me datën 08.09.2016 nga z. Feti Krasniqi kemi pranuar dokumentin zyrtar të lëshuar nga ARBK-ja, ku dëshmohet se ne Biznesin me nr.70775735 dhe me emër N.P.SH “Agro-Meti” z. Feti Krasniqi nuk figuron me si person i autorizuar.

Vlerësojmë se pas veprimeve të ndërmarra nga zyrtari i lartë, z. Feti Krasniqi, Drejtor i Drejtoratit për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Lipjanit, duke u larguar nga funksioni i personit të autorizuar ne një biznesin privat dhe pasi janë analizuar dëshmitë lidhur me angazhimin e tij ne OJQ-në “NOE” konstatojmë se janë krijuar rrethana të reja dhe është shmangur gjendjen e mundshme e konfliktit të interesit dhe mospajtueshmërisë ne ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja,

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)



Shaip Havolli

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit